

**FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE  
KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK**

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor: **Agjencia e Blerjeve të Përqendruara**  
**Adresa: Blv "Dëshmorët e Kombit" Nd. 1, 1001, Tiranë.**

Ankesë drejtuar: **Komisionit të Prokurimit Publik**

**Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit**

*Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomike)*

**NRG shpk**

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

**L13426006B**

Nuis/Nipt

**Farkë, Rruga "Eduart Mano", Pallatet Nr . 10, Kopshti Zologjik, Selitë**

Adresa

**Tiranë**

Qyteti

**Shqipëri**

Shteti

Kodi Postar / Posta

**(+355) 672031918/9**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

**nrgshpk@gmail.com**

E-mail

**Marco Genicco – Administrator**

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

**2022/09/12**

Data (viti/muaji/dita)

**(+355) 672031918/9**

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II. Informacion mbi procedurën

### 1. Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentet e tenderit.*  
**REF-48360-11-02-2022**

### 2.Lloji i Procedurës

*Plotësoni llojin e procedurës së përdorur për prokurimin në fjalë.*

Procedurë e hapur <input type="checkbox"/>	<b>Procedurë e hapur e thjeshtuar</b> <b>X</b>
Procedurë e kufizuar <input type="checkbox"/>	Procedurë konkurruese me negociim <input type="checkbox"/>
Partneritet për inovacion <input type="checkbox"/>	Dialog konkurrues <input type="checkbox"/>
Procedurë me negociim me shpallje paraprake të njoftimit <input type="checkbox"/>	Procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës <input type="checkbox"/>
Shërbim Konsulence <input type="checkbox"/>	
Kontratë e lidhur pa zhvilluar ndonjë nga procedurat e prokurimit të parashikuara në LPP <input type="checkbox"/>	

### 3. Autoriteti /Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administron procesin e prokurimit.*  
**Agjencia e Blerjeve të Përqendruara**

### 4. Vlera e përlogaritur e prokurimit

*(Vlera e përlogaritur e kontratës/marrëveshjes kuadër) (shuma në shifra dhe fjalë)*

**3,232,130** (tre milion e dyqind e tridhjetë e dy mijë e njëqind e tridhjetë) **Lekë pa TVSH**

### 5. Objekti i kontratës/Marreveshjes Kuadër

*(Përshkrimi i shkurtër i punëve / mallrave / shërbimeve objekt kontrate/marreveshje kuader).*

## Shërbim Dezinfektimi, Deratizimi dhe Dezinfektim për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh

6. Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*(Data (viti/muaji/dita)*

**2022/11/14**

7. Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

*(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)*

8. **Data e nënshkrimit të kontratës**

*(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave nër pavlefshmërinë e kontratës)*

---

### Seksioni III. Përshkrimi i ankesës

1. Baza ligjore (Shkelje ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

**Hartimi i kritereve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike është bërë në kundërshtim me LPP dhe RrPP**

#### 2. Objekti i ankesës

- **Modifikim i dokumentave të tenderit**

**X**

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

*(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)*

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ve ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

*(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)*

- Pavlefshmëri kontrate

*(Citoni kontratën për të cilën kërkon pavlefshmërinë)*

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### 3. Rrethanat dhe faktet

*Përshkruani rrethanat e faktit.*

**Njësia e hartimit të dokumentave të tenderit ka vendosur kritere kualifikimi në kundërshtim me LPP dhe RrPP dhe ka hartuar specifikime teknike të cilat sjellin ulje të konkurrencës.**

### 4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Në datë 03.11.2022 u njohëm me dokumentat e tenderit për procedurën e prokurimit me objekt: Shërbim Dezinfektimi, Deratizimi dhe Dezinsektim' për Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Gramsh.

Në kriteret e veçanta të dokumentave të tenderit është kërkuar: *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2019, 2020, 2021), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare*

Në Nenin 2 "Qëllimi" të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se:

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik...*

Ndërsa në Nenin 3 "Parime të përgjithshme" të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*

*2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

*3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

Në Nenin 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" të ligjit 162/2021 "Për prokurimin publik" parashikohet se: *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, tëparashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi...*

Në Nenin 77 "Kërkesat për kualifikim", të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin public" parashikohetshprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim përoperatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
  - b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
  - c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.*
- Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës...*

Në nenin 43 të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, parashikohet se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .*

*2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:*

- a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin elartë monetar;*
- b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;*
- c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit Shërbim konsulence.*

Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e

biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPPsë.

Sa më sipër kërkohet që ky kriter të modifikohet duke përcaktuar një vlerë limit të xhiros jo më të madhe së 40% e vlerës së fondit limit pra vlera maksimale të përcaktohet deri në 40%.

Në kriteret e veçanta të dokumentave të tenderit është kërkuar:

2. *Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:*

a) **1 (një) Drejtues Teknik.** *Për drejtuesin teknik te paraqitet:*

- *Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.*
- *Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.*
- *Kontrate pune perkatese.*
- *Librezë pune.*
- *Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet te figuroje i dy punesuar ne sektor privat apo publik. Per kete Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise te paraqes deklarate perkatese.*
- *Drejtuesi nuk duhet te jete i angazhuar ne kontrata te tjera gjate periudhes se realizimit te objektit. Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise.*

Bazuar në nenin 75 të LPP kërkohet modifikimin e këtij kriteri si më poshtë vijon:

3. *Operatori ekonomik për kryerjen e shërbimit, objekt prokurimi duhet të ketë te punesuar staf si me poshte:*

b) **1 (një) Drejtues Teknik.** *Për drejtuesin teknik te paraqitet:*

- *Diplomë ose certifikatë kualifikimi me profesion Agronom/Shëndet Publik/Biologji/Kimi.*
- *Duhet të ketë minimalisht 2 (dy) vite eksperiencë pune. Te paraqitet detyrimisht deklarata e kontributeve te sigurimeve shoqerore individuale e leshuar nga e - albania.*
- *Kontrate pune perkatese.*
- *Ne zbatim te akteve ligjore, drejtuesi i mesiperm nuk duhet te figuroje i dy punesuar ne sektor privat apo publik. Per kete Administratori/Drejtuesi Ligjor i shoqerise te paraqes deklarate perkatese.*

Kërkesa që Drejtuesi Teknik nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera gjatë periudhës së realizimit të objektit nuk është e bazuar në ligj. Per tu pajisur me licencën II.8.B “Për shërbime

ndërhyrëse higjeno-sanitare”, duhet të vërtetohet se disponon një Drejtues teknik të profileve biolog, kimist, agronom ose shëndet publik. Drejtues teknik në këto terma, do të drejtojnë të gjithë aktivitetin e këtij subjekti pra të gjitha kontratat që ka shoqëria dhe jo të kemi një drejtues teknik për secilën kontrat të nënshkruar.

Sipas këtij kriteri duhet që një shoqëri të ketë Drejtues Teknik për çdo objekt shtetëror apo privat që ka kontraktuar dhe një të veçantë për objektin tuaj ndërkohë që Drejtuesi Teknik është një dhe i vetëm.

Një kriter i tillë mund të funksiononte në sektorin e ndërtimit po jo në sektorin e shërbimeve në fjalë. Referuar termave të referencës dhe shpeshësisë së kryerjes së këtij shërbimi, nuk është e nevojshme që drejtuesi teknik të angazhohet gjatë gjithë kohës për kryerjen e shërbimit pasi shërbimi do të kryhet çdo 2 javë ose çdo 4 javë sipas teknikës.

Libreza e punës është kërkesë e tepërt dhe është personale e punonjësit nuk mund të përdoret pa pëlqimin e tij në asnjë vend të botës. Edhe në kontratën e punës nuk ka nen i cili i jep të drejtë Punëdhënësit të japë të dhëna personale siç është libreza e punës për palë të treta qofshin këto institucione prokuruese apo të ngjashme.

Ky dokument ka historikun personal të punës që nuk mund të publikohet pa autorizimin e punonjësve

Në kriteret e veçanta të dokumentave të tenderit është kërkuar **2.3 Kapaciteti teknik**

*pika 2 Operoret ekonomike me ane të një deklaratë, duhet të marrin persiper, se me nënshkrimin e kontrates, duhet të paraqes për çdo produkt, raport-testimet si dhe certifikimet perkatese, të cilat duhet të jene sipas percaktimeve të specifikimeve teknike të AK, të leshuara nga organet kompetente të akredituara,*

*dhe*

*pika*

*3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë ku të deklarojë se, produktet Biocide që do të përdoren për dezinfektim, janë në listën e lëndëve që përdoren për dezinfektim, të miratuar nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*

AK ka cituar se “Produktet Biocide me përmbajtje të lëndëve aktive të mësipërme trajtohen sipas VKM nr. 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”;

VKM nr 933 date 25.11.2020 e cila parashton qarte dhe paster çfare dokumentacioni duhet të plotesoje një operator ekonomik për marrjen e lejes se importit të produkteve biocide nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale. Në bazë të VKM nr. 933 datë 25.11.2020, operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë Ministrisë së Shëndetësisë dokumentet.

Pra dokumentacioni që duhet të kërkohet nga AK është:

- *Autorizim prodhuesi ose Leje Importi*
- *MSDS ne gjuhen shqipe dhe ne gjuhen e origjines*
- *Certifikatw rregjistrimi ne Europe, Kanada ose ne USA ne gjuhen Shqipe dhe te origjines*

Keto dokumente nuk duhet të vërtetohen vetem me deklarata por duhet te dorwzohen si dokumentet faktike per ti vertetuar AK qe disponon kapacitetet teknike per kryerjen e ketij shërbimi prandaj kwrkojmw qw tw shtohen si kriter kualifikimi.

Nga AK kërkohet që operatori ekonomik të dorëzojë raport testimi nga organet kompetente të akredituara për produktet me të cilat do të kryhet shërbimi, ndërkohë që, në Shqipëri nuk ka asnjë organ të akredituar për kryerjen e testimeve për produktet biocide/produktet me të cilat kërkohet të kryhet ky shërbim.

Gjithashtu kërkohet që të paraqese raport analizë për një produkt që MSHMS jep leje importi në bazë të mostrave që dërgohen për analizë nga operatori ekonomik. Dhe në asnjë moment operatori ekonomik nuk pajisjet me raport analizë kur kryhen analizat nga autoriteti kopotent. Në këto kushte kërkohet që ky specifikim të hiqet nga kriteret e tenderit.

Neni 3 ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.**
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.**

Neni 21 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohen se: **“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.**

Neni 36 i ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

**“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të**



marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

c) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

*Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.*

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se *duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.*

Sa më sipër, autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë kriteret që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Rrjedhimisht autoriteti kontraktor është në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret dhe specifikime teknike në lidhje me produktin e kërkuar, por pa përcaktuar kriteret të cilat të çojnë drejt një marke të caktuar, apo që nuk ndikojnë në performancën e produktit, pasi përcaktimet të tilla janë diskriminuese dhe përjashtuese nga pjesëmarrja në procedurë të operatorëve ekonomikë të interesuar.

*Në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk duhet të vendosë kriteret apo të hartojë specifikime teknike të cilat të drejtojnë në një emër të caktuar marke apo prodhuesi, si edhe specifikime teknike të paqarta e konfuze, duke u bërë kështu përjashtues për operatorë të tjerë për një konkurrencë të hapur e të gjerë, bazuar kjo në përcaktimet e legjislacionit për prokurimin publik si më sipër cituar.*

Bazuar sa më sipër po parashtrijmë vërejtjet dhe sygjerimet tona në lidhje me specifikimet teknike për këtë procedurë prokurimi me qëllim rritjen e konkurrencës së lirë dhe të ndershme midis OE:

Në bazë të kërkesës të AK për Produkte Biocide të kërkuar disa herë tek Shtojca e Specifikimeve Teknike është e qartë se bazoheni në Rregulloren Europiane nr. 528/2012 “Mbi rregullimet e produkteve biocide” dhe V.K.M. nr. 933/2020 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”. Sa më sipër rezulton se mund të importohen dhe regjistrohen nga M.SH.M.S. vetëm produkte biocide janë të regjistruara në ECHA dhe të paktën në një nga vendet e BE.

Produkti me pricip aktiv deltametrine regjistruar si biocide kanë humbur përdorimin në ambjentet e jashtme mbi të gjitha përsa i përket sipërfaqeve të gjelbra. Gjithashtu është hequr përdorimi e kësaj lëndë aktive mbi mushkonjat specifiku. Produktet lëndë aktive deltametrine përdoren kryesisht në ambiente të brendshme, ndërsa në ambjentet e jashtme vetëm trajtim i mureve, të çarave, fisurave e të tilla.

Për kontrollin e insekteve zvarritëse është kërkuar një Biocid me bazë Neo Nikotinoide (dhe jo Neuro Nikotinoide) me lëndë aktive Imidacloprid. Kjo familje ka të tjera lëndë aktive të cilët janë shumë më eficiente të tilla si Dinotefuran, Acetamiprid etj. Në kushtet kur është kërkuar vetëm një lëndë aktive, konkurrenca është e kufizuar pasi vetëm një OE mund ta ofrojë atë. Sa më sipër dhe bazuar në LPP dhe RrPP kërkojmë që të kërkohen edhe lëndët aktive të tjera me qëllim hapjen e konkurrencës.

Përsa i përket produkteve rodenticit me bazë anti-koagulant gjithmonë duke folur për produkte biocide është kërkuar coumatetralyl që është një lëndë aktive e gjeneratës së parë e cila është hedhur në treg në vitet 1957 dhe që ka LD50 prej 16,6 mg/kg. Duke marrë në konsideratë se kanë dalë produkte të gjeneratës së II dhe të III me prfil më të mirë toksikologjik dhe më efikase të tilla si Bromadiolon, Difenacoum, Difethialon, Brodifacoum, Flocoumafen etj kërkojmë që të përfshihen edhe lëndët aktive të të gjithë antikoagulantëve të gjeneratës së II dhe të III. Tjetër gjë që duhet theksuar është se etiketa e rodenticiteve për përdorim profesional kërkon njëshërbim në statcioniet e karremit çdo 5 ose 7 ditë në rast të prezencës së brejtësve. Në specifikimet teknike nuk është përshkruar saktësisht ajo që jepet në etikë për përdorimin e produktit dhe siç shpjegohet në përdorimin ambjental të rodenticiteve (CEFIC).

Preparati për dezinfektim në ambjentet sensitive më lëndë aktive Pyrethrin ose Pyrethrum dhe Piperonyl butoxide nuk ka asnjë regjistrim si produkt biocid prandaj kërkojmë që të hiqet ose të zëvendësohet me produkte me veprim mekanik ose kurthe monitoruese.

**5. Kërkesë për ekspertizë të posacme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit /Enti Kontraktor dhe Komisionit te Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/ entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail: info@nrg.com.al**

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori i "NRG" shpk**

